“Ka shpëtuar ai që është bërë musliman, është furnizuar mjaftueshëm dhe Allahu e ka bërë të kënaqur me atë që i ka dhënë.”

Abdullah ibn Amër ibn Asi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se i Dërguari i Allahut ﷺ ka thënë: “Ka shpëtuar ai që është bërë musliman, është furnizuar mjaftueshëm dhe Allahu e ka bërë të kënaqur me atë që i ka dhënë.”
[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Profeti ﷺ në këtë hadith sqaroi se ai që i dorëzohet Zotit të tij, udhëzohet dhe drejtohet në Islam, dhe furnizohet me aq sa i mjafton prej riskut hallall për të përmbushur nevojat e tij, pa tepri dhe pa mangësi, dhe Allahu e bën të kënaqur e të pajtuar me atë që i ka dhënë, ai vërtet ka arritur suksesin dhe ka fituar.

http://sunnah.global/hadeeth/sq/show/5814